

VENDIM
Nr.146, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST
SHA PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a., për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012–2014), do të jetë 0.65 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.
Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani